

Tetor
2017

FOL

KOMUNAT DHE

ROLI I TYRE NË PUNËSIMIN E TË RINJVE

Ekziston një perceptim i përgjithshëm në Kosovë se zhvillimi ekonomik dhe punësimi janë të drejta ekskluzive dhe përgjegjësi e qeverisë qendrore dhe se komunat faktikisht nuk kanë kurrfarë roli në të. Një qasje e tillë mund të vërehet më së miri në kohë zgjedhjesh ku askush nuk dëshiron të pyes kandidatët nëse kanë ndonjë plan se si të rrisin zhvillimin ekonomik dhe të krijojnë vende pune. Ky dokumenti i shkurtër i politikave ka për qëllim t'ia përkujtojë publikut të përgjithshëm se komunat kanë një rol direkt në zhvillimin e ekonomisë dhe në krijimin e vendeve të punës përmes zgjedhjes së politikave dhe strategjive lokale që janë brenda kompetencave ligjore të komunave.

Copyright © 2017.
Autori Jeton Zulfaj

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të Lëvizjes FOL

Përkrahur



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

EYE

Enhancing Youth
Employment

Ky punim është përgatitur në kuadër të projektit “FOL Hapur” i cili mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe realizohet nga Helvetas Swiss Cooperation dhe MDA. Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht përgjegjësi e Lëvizjes FOL, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimet e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim ose të Departamentit Zviceran për Marrëdhënie të Jashtme

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Përmbledhje ekzekutive | 6 |
| Hyrje | 7 |
| Kompetencat ligjore të komunave | 9 |
| Kompetencat në fushën e zhvillimit ekonomik dhe vet-qëndrueshmërisë | 9 |
| Mësimet nga literatura | 11 |
| Krijimi i vendeve të punës | 11 |
| Ofrimi i të dhënave për ekonominë lokale | 12 |
| Marketingu | 12 |
| Krijimi dhe mbajtja e zonave industriale | 13 |
| Stimulimet tatimore | 13 |
| Strategjitë/politikat për mbështetjen e bizneseve lokale | 14 |
| Kreditë e subvencionuara/me kosto të ulët dhe grantet | 14 |
| Ku jemi ne? | 17 |
| Gjendja e tregut të punës | 17 |
| Gjendja e mjedisit për biznes | 18 |
| Roli i komunave në arsimin dhe aftësimin profesional dhe në punësim | 21 |
| Aftësimi profesional në Kosovë | 22 |
| Vlerësimi i tregut për Sistemin e Tregut të Aftësive të AAP-së -- përmbledhje nga vlerësimi Përmirësimi i Punësimin të Rinjve në vitin 2016 shkruar nga (Strategy & Development Consulting) | 22 |
| Sektori privat: | 23 |
| Drejtoritë Komunale të Arsimit | 25 |
| ANALIZË | 27 |
| Roli i komunave në zhvillimin ekonomik | 27 |
| Zgjedhjet e politikave | 27 |
| Trajnimi dhe zhvillimi ekonomik shkojnë së bashku | 28 |
| Përfundim | 31 |

Përmbledhje ekzekutive

Kjo përmbledhje e politikave ka për qëllim të shërbejë si dokument diskutimi për një politikë specifike, e që është roli i komunave në zhvillimin ekonomik dhe punësim.

Ekziston një perceptim i përgjithshëm në Kosovë se zhvillimi ekonomik dhe punësimi janë e drejtë ekskluzive dhe përgjegjësi e qeverisë qendrore dhe se komunat faktikisht nuk kanë kurrfarë roli në të, duke e ngushtuar atë rol vetëm në ofrimin e shërbimeve bazike. Një qasje e tillë mund të vërehet më së miri në kohë zgjedhjesh ku askush nuk dëshiron të pyes kandidatët nëse kanë ndonjë plan se si të rrisin zhvillimin ekonomik dhe të krijojnë vende pune. Kjo përmbledhje e shkurtër e politikave ka për qëllim t'ia përkujtojë publikut të përgjithshëm se komunat kanë një rol direkt në zhvillimin e ekonomisë dhe krijimin e vendeve të punës përmes zgjedhjes së politikave dhe strategjive lokale që janë brenda kompetencave ligjore të komunave.

Kjo përmbledhje e politikave e shtjellon rolin e komunave duke analizuar kompetencat e tyre aktuale ligjore dhe duke ofruar një varg zgjedhjesh politike nga tekstet shkollore, të gjitha këto në kuadër të kompetencave të tyre ligjore.

Komunat mund dhe duhet të punojnë në planet dhe strategjitë e zhvillimit ekonomik. Ato janë përgjegjëse për licencimin e veprimtarive afariste, për aplikimin e tatimeve dhe pagesave, sigurimin e infrastrukturës dhe arsimin bazik dhe miratimin e rregulloreve që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e vendeve të punës.

Hyrje

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 e përkufizon komunën si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron **tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.**

Përmes parimit të subsidiaritetit, komunat në Kosovë kanë kompetenca të mjaftueshme të rregullojnë çdo zonë e cila nuk rregullohet shprehimisht nga niveli qendror.

Kjo është shumë me rëndësi kur është fjala për zhvillimin e përgjithshëm të komunës e cila ka vizionin, shtytjen dhe resurset por iniciativat e saj mund të bllokohen nga niveli qendror.

Është e qartë se komunat nuk e kanë shfrytëzuar sa duhet këtë parim kur është fjala për zhvillimin ekonomik.

Listat e Bankës Botërore e radhisin Kosovën si vend me të hyra të mesme të ulëta dhe sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e përgjithshme e papunësisë në Kosovë mbetet në 28% ndërsa tek të rinjtë ajo arrin deri në 50%.

Kjo shtron pyetjen mbi rolin e komunave në gjenerimin e rritjes ekonomike dhe punësimit. Sipas statistikave të qeverisë, mbi 30,000 të rinj hyjnë në tregun e punës çdo vit, ndërsa gjysma e tyre nuk mund të gjejnë punë, duke e rritur kështu armatën e të papunëve.

Literatura sugjeron se komunat duhet të luajnë një rol kur është fjala për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës. Varësisht nga politikat që zhvillojnë, ato mund të tërheqin biznese të reja të cilat drejtpërdrejtë mund të krijojnë vende pune për të rinjtë.

Ndoshta një prej politikave kryesore që mund të thuhet se është në dorën e komunave është arsimi. Duke përdorur kompetencat aktuale ligjore, komunat madje mund të krijojnë agjenci të specializuara për ofrimin e trajnimeve profesionale që i përgatisin punëtorët që të jenë më mobil nëpër sektorë dhe më të aftë për të plotësuar kërkesat e tregut.

Në këtë dokument, ne synojmë të nisim një debat të shoqërisë civile mbi rolin e komunave në zhvillimin ekonomik dhe punësim në mënyrë që

qytetarët të jenë më aktivë dhe të kërkojnë llogari nga përfaqësuesit e tyre.

Fatkeqësisht, kjo përmbledhje e politikave nuk do të jetë në gjendje të bëjë një analizë të plotë të politikave dhe veprimeve aktuale të ndërmarra nga komunat e ndryshme, e as nuk do të analizojë të gjitha strategjitë e nivelit qendror dhe lokal për krijimin e vendeve të reja të punës dhe tërheqjen e bizneseve, ose të shqyrtojë të gjitha statistikat dhe treguesit e investimeve aktuale, performancës dhe qasjes.

Çka do të bëjë kjo përmbledhje është të përzgjedh të dhëna të ndryshme dhe të sjell në debat një varg instrumentesh që dalin nga librat shkollorë që mund tu ndihmojnë komunave të rishikojnë qasjen e tyre në krijimin e vendeve të punës.

Përmbledhja do të analizojë kompetencat ligjore të komunave për zhvillim ekonomik; ajo do të sjell materiale nga tekstet e autorëve të ndryshëm për atë se si bëhet i mundur gjenerimi i vendeve të reja të punës me kompetencat e tanishme ligjore; ajo jep një pasqyrë të përgjithshme të treguesve kryesorë për atë se si është gjendja në aspektin e rritjes ekonomike dhe punësimit bazuar në faktet dhe shifrat e përzgjedhura. Ajo po ashtu informon për rolin e komunave në arsim si një mjet i rëndësishëm për rritjen e zhvillimit ekonomik dhe përpiqet të bëjë një analizë të shkurtër të të gjithë faktorëve dhe përfundon duke dhënë disa rekomandime të përgjithshme që ne besojmë se mund të aplikohen për të gjitha komunat.

Ne po ashtu kemi bashkëngjitur një broshurë faktesh me statistika nga Agjencia e Statistikave të Kosovës me tregues që ndihmojnë lexuesin për të kuptuar më mirë kontekstin e situatës.

Kompetencat ligjore të komunave

Kompetencat në fushën e zhvillimit ekonomik dhe vet-qëndrueshmërisë

Parimi i subsidiaritetit në BE

Neni 5(3) i Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) thekson se “*për fushat që nuk bien në kompetencën ekskluzive të tij, Bashkimi vepron vetëm nëse dhe për aq sa objektivat e veprimit të propozuar nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare në nivel qendror ose në nivel rajonal dhe vendor, por mund të arrihen më mirë në nivel Bashkimi duke pasur parasysh shkallën apo efektet e veprimit të propozuar.*”

Në BE, parimi i subsidiaritetit udhëhiqet nga logjika e llogaritësit të “efikasitetit krahasues”, i cili përfshin një vlerësim se a mund të arrihen objektivat e një mase më mirë në nivel të Bashkimit apo Shtetit Anëtar apo në atë lokal. Si parim ligjor, subsidiariteti ka për qëllim të kufizojë përdorimin e kompetencave të legjislaturës së Bashkimit.

Parimi i subsidiaritetit në BE

Parimi i subsidiaritetit është parim i fuqishëm që u mundëson komunave të veprojnë dhe rregullojnë fushat në të cilat nuk vepron qeverisja qendrore ose rajonale dhe ku qëllimet mund të arrihen më mirë duke vepruar në nivel komunal.

Neni 15 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë thekson se “*Komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit.*”

Neni 17 i të njëjtit ligj specifikon se komunat “*kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjisllacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë*”

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.

Neni 30 i të njëjtit ligj më tej përcakton se “*komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me organe të huaja të vetëqeverisjes lokale*

në të gjitha fushat e kompetencave vetanake komunale dhe kompetencave të zgjeruara, me përjashtim të atyre në paragrafin 2 të nenit 40 të këtij ligji.”

Sa i përket financave, ligji Nr. 03/L-49 shënon kompetencat e qeverisë lokale në gjenerimin e të hyrave që e bëjnë komunën të vetë-qëndrueshme. Në mesin e kompetencave në kapitullin III janë shënuar kompetencat e mëposhtme të komunës për taksa dhe pagesa:

- a) **Taksa për Lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë Afariste** - komuna, me rregullore komunale, mund të themelojë një taksë vjetore e cila duhet të paguhet nga organizatat e regjistruara afariste për të marrë ose mbajtur një leje të tillë për veprimtari afariste. Një rregullore e tillë po ashtu mund të themelojë një regjistër të taksave të ndryshme të cilat caktohen për kategoritë e ndryshme të aktiviteteve afariste. Çdo taksë e tillë për veprimtari afariste duhet të vlerësohet vetëm në bazë të rregullave të përcaktuara me rregullore komunale.
- b) **Taksa për Lejen për Shërbime Profesionale** - komuna, me rregullore komunale, mund të caktojë një taksë vjetore e cila duhet të paguhet për të marr apo mbajtur një leje të tillë për ushtrimin e veprimtarisë afariste profesionale. Një rregullore e tillë po ashtu mund të themelojë një regjistër të taksave të ndryshme të cilat caktohen për kategoritë e ndryshme të shërbimeve profesionale.

Siç do ta shohim më poshtë nga pjesa e literaturës, këto kompetenca janë thelbësore në hartimin e politikave ekonomike që mund të çojnë në zhvillim ekonomik dhe vende të reja pune.

Mësimet nga literatura

Pjesa e literaturës në këtë politikë bazohet shumë në dokumentin e punës nga Cray et al. për Hulumtimin mbi Punën dhe Punësimin, i cili është edhe plan për qeveritë lokale që të shqyrtojnë politikën dhe strategjitë e tyre për krijimin e vendeve të punës dhe për tërheqjen e bizneseve.

Komunat ose qeverisja lokale duhet të luajnë një rol vendimtar kur është fjala për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës. Zhvillimi ekonomik varet jo vetëm nga aktiviteti i sektorit të biznesit, por edhe nga politikën e zhvillimit ekonomik që zhvillohen nga autoritetet publike të niveleve qendrore, rajonale dhe lokale. Meqë kjo përmbledhje e politikave ka të bëjë me rolin e komunave në zhvillimin ekonomik dhe punësim, ne nuk fokusohemi në rolin, kompetencat dhe politikën e qeverisjes qendrore dhe rajonale.

Krijimi i vendeve të punës

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) thekson se agjencitë lokale të punësimit dhe trajnimit mund të luajnë rol integral në hartimin e strategjive për të nxitur krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e produktivitetit, por vetëm kur të integrohet në mënyrë efektive me zhvillimin ekonomik (OECD, 2013).

Për Cray et al. qeveritë lokale përpiqen të krijojnë një klimë të përshtatshme për biznes përmes stimulimeve sepse disa teori në anën e ofertës theksojnë se firmat do të vendosen aty ku i minimizojnë shpenzimet, duke e rritur kështu kreditë e punësimit lokal (Cray, et al.)

Bizneset duan të operojnë në zonat me shpenzime të ulëta ku ka potencial për minimizimin e shpenzimeve dhe komunat mund të zbatojnë politika që mund të tërheqin bizneset.

Për Cray, et.al strategjitë për tërheqjen e bizneseve paraqesin valën e parë të praktikës së zhvillimit ekonomik, ku lokalitetet (*komunat*¹) përpiqen të vënë në shënjestër firmat me oferta të ndihmës në para dhe ngjashëm me para, në formë të kredive të subvencionuara dhe lirimeve tatimore, për të inkurajuar zhvendosjen e tyre.

Strategjitë për mbajtjen e bizneseve janë pjesë e valës së dytë të zhvillimit ekonomik që fokusohet në marrjen e informatave mbi nevojat e bizneseve

¹ E shtuar nga autori

lokale, e pastaj në veprimet inkurajuese të qeverisë për të plotësuar më mirë nevojat dhe për të rritur përfitimet lokale. Programet për mbajtjen e bizneseve sillen prej programeve të vizitimit dhe studimit të bizneseve, deri te rajonet e planifikuara prodhuese dhe grupet e bizneseve.

Teoria e zinxhirit të vendeve të punës ngrihet mbi idenë se rritja e bizneseve krijon vende pune duke parashtruar se, kur një industri zgjerohet, krijohen pozita për staf të ri në të gjitha nivelet e vendeve të punës, duke u mundësuar punëtorëve të nivelit të ulët dhe të mesëm të ngrihen në zinxhir dhe eventualisht duke hapur mundësi për punëtorët e pakualifikuar e të papunë (Cray, et al.).

Në vijim janë dhënë shembuj të strategjive më të përdorura për tërheqjen dhe mbajtjen e bizneseve.

Ofrimi i të dhënave për ekonominë lokale

Organizatat e zhvillimit ekonomik lokal shpesh përpiqen të japin informacione të mira dhe ndihmë me leje dhe rregullore të zonimit për qëllime të bizneseve. Kjo mund të ndikojë në kompanitë e mëdha që kërkojnë një objekt për ta vënë në funksionim shpejt. Ofrimi i informatave të besueshme për këto lokacione, dhe ndihma në tejkalimin e problemeve me leje dhe rregullore mund të ndihmojnë në krijimin e vendeve të punës duke tërhequr bizneset dhe duke u kursyer kohën bizneseve fillestare.

PËRPARËSITË

Qasja në informacione. Kjo mundëson krijimin e vendeve të punës duke u dhënë bizneseve më shumë informacione për përparësitë krahasuese të qytetit për të cilat ata ndryshe nuk do të kishin dijeni.

Kostoja efektive. Ofrimi i informacioneve bazike bizneseve kërkon shpenzime relativisht modeste të stafit të zhvillimit ekonomik.

Transparenca dhe llogaridhënia. Bërja më efikase dhe sigurimi i transparencës për qasje në informacione mbi aktivitetet e zhvillimit ekonomik ndihmon në rritjen e llogaridhënies ndaj publikut.

Marketingu

PËRPARËSITË

Përmirësimi i efikasitetit. Tërë ky aktivitet i marketingut rezulton në një shpërndarje më të madhe të informatave për çështjet e lokacionit të bizneseve, e cila pastaj e rrit efikasitetin në ndarjen e resurseve.

Kostoja efektive. Edhe pse marrin shumë kohë, aktivitetet e shitjes mund të jenë me kosto më efektive pasi që ato fokusohen në ndërtimin e marrëdhënieve për të tërhequr bizneset e jo subvencionet financiare.

Krijimi dhe mbajtja e zonave industriale

Komponentët e këtyre programeve përfshijnë identifikimin dhe përgjigjen në nevojat e bizneseve, krijimin e zonave të planifikuara të prodhimit në mënyrë që të parandalohet konkurrenca për tokë për përdorime të ndryshme, dhe zhvillimin e parqeve industriale me shërbime të ofruara nga qyteti.

PËRPARËSITË

Mbajtja e vendeve të punës në prodhimtari. Nëse qytetet mund të përdorin mjetet për planifikimin e shfrytëzimit të tokës për të mbajtur prodhimtarinë, atëherë ato mund të ofrojnë vende të punës dhe rritje të pagave për banorët e vet qytetit. Planifikimi dhe zonimi më efektiv mund të ndihmojë në uljen e koston së të bërit biznes për prodhuesit.

Tërheqja e furnizuesve lokalë. Kjo strategji po ashtu mund të ndërtohet mbi konceptin e bashkimit, nëse furnizuesit lokalë tërhiqen dhe mbahen si rezultat i zonave prodhuese, kjo rrit vendet e punës në nivel rajonal.

Stimulimet tatimore

Stimulimet tatimore për krijimin e vendeve të punës përdoren nga të gjitha shtetet dhe nga shumica e lokacioneve në ndonjë formë dhe përbëjnë pjesën më të madhe të resurseve publike që përdoren në zhvillimin ekonomik. Ato përfshijnë uljen e tatimit në pronë, lirimet nga tatimi në shitje dhe kredi, lirimet nga tatimi në të ardhura të korporatave dhe kredi të taksës së vendeve të punës, të lidhur me numrin e punëtorëve të punësuar. Meqë firmat po bëhen më mobile për shkak të zvogëlimit të kostove të transportit dhe komunikimit, politikat tatimore të shtetit dhe pushtetit lokal janë një mënyrë për të ndikuar në kostot e biznesit dhe për të ndikuar në vendimet për lokacionin. Prandaj, stimulimet për tërheqjen ose mbajtjen e bizneseve janë të arsyeshme nga ithtarët e tyre si kosto që sjellin përfitime e mundshme të një punësimi më të madh dhe një shteti më të fuqishëm dhe gjendje më të mirë fiskale lokale.

Strategjitë/politikat për mbështetjen e bizneseve lokale

Kreditë e subvencionuara/me kosto të ulët dhe grantet

Programet për qasje në kapital ofrojnë kapital me kosto të ulët për të tërhequr dhe zgjeruar bizneset përmes mjeteve siç janë kreditë direkte nga fondet kreditore për zhvillim të komunitetit, të cilat janë ndër programet më të zakonshme të mbështetura nga qeveritë lokale. Garancitë kreditore të qeverisë për inkurajimin e institucioneve financiare për tu dhënë kredi bizneseve, subvencionet për rezervat e bankave në rast humbesh nga kreditë, dhe programet për zgjerimin e ndërmarrjes apo kapitalit fillestar në dispozicion janë disa forma tjera të ndihmës financiare për bizneset. Këto programe janë në përgjithësi të hapura për bizneset e të gjitha madhësive, por ndikimi i tyre për biznesin është më i madh kur përdoren për financimin e aktiviteteve të bizneseve të vogla.

Për Batic-un, zhvillimi ekonomik lokal është dëshmuar se ndikohet nga aktivitetet e qeverisë lokale. Megjithatë, politika e zhvillimit ekonomik lokal zakonisht definohet më ngushtë si aktivitete të veçanta, që ndërmerren nga grupe publike ose private, për të promovuar zhvillimin ekonomik e që ndahen në dy kategori:

1. Ofrimi i ndihmës së përshtatur që ka si synim bizneset individuale që mendohet se sjellin përfitime më të mëdha për zhvillimin ekonomik; dhe
2. Nismat strategjike përmes të cilave ndryshohen politikat e përgjithshme tatimore, të shpenzimeve dhe ato rregullative të qeverisë për të promovuar zhvillimin ekonomik lokal. (Bartik, 2003)

Për Bartik-un (Bartik, 2003), zhvillimi ekonomik lokal po shihet gjithnjë e më shumë si përgjegjësi kryesore e qeverisë lokale, që kërkon resurse të konsiderueshme të qeverisë, jo më pak edhe në formë të heqjes dorë nga të hyrat tatimore. Ai identifikon disa tema të zakonshme që duhet të ndiqen nga qeveritë lokale për të rritur zhvillimin ekonomik dhe për të krijuar vende pune.

Sytë tek rezultati përfundimtar. Zhvillimi ekonomik lokal duhet të fokusohet në ofrimin e punësimit dhe përfitimeve fiskale për banorët lokalë, duke ruajtur në të njëjtën kohë cilësinë lokale të jetës. Vlerësimet e programeve të zhvillimit ekonomik lokal duhet të fokusohen në atë se si programi ndikon në arritjen e këtyre qëllimeve. Për rritjen e pasurisë lokale, zhvillimi ekonomik lokal duhet të zgjerojë veprimtarinë e bizneseve

që eksportojnë jashtë ekonomisë lokale, të zëvendësojnë importet në ekonominë lokale, të rrisin produktivitetin ose përdorin më mirë resurset lokale që nuk janë shfrytëzuar sa duhet, siç janë punëtorët që është vështirë të punësohen dhe toka e kontaminuar.

Portfolio e gjerë. Një politikë gjithëpërfshirëse për zhvillimin ekonomik lokal do të përfshijë strategjitë e fokusuara në tërheqjen e bizneseve, mbajtjen e bizneseve, bizneset e reja fillestare, teknologjinë e lartë, dhe tokën shfrytëzimi i të cilës ngrit shqetësime të veçanta.

Vënia në shënjestër. Që politikat e zhvillimit ekonomik lokal të jenë më efikase, programet duhet të drejtohen kah bizneset që kanë më shumë mundësi të krijojnë punësim të konsiderueshëm dhe përfitime fiskale, **që përfshinë bizneset që duan të përfshihen në trajnime lokale dhe programe të punës.** Programet e financimit duhet të drejtohen kah bizneset sjellja e të cilave ka mundësi të preket, siç janë bizneset me lokacione të mira alternative, ose bizneset që nuk kanë mundësi të marrin financim normal bankar.

Trajnimi dhe zhvillimi ekonomik shkojnë së bashku. Për të rritur në mënyrë efektive veprimtarinë afariste dhe për të sjell përfitime nga punësimi, programet e zhvillimit ekonomik lokal duhet të përfshijnë programe të përshtatura të trajnimit që në mënyrë efektive tu shërbejnë nevojave të dy llojeve të klientëve, komunitetit të biznesit dhe të papunëve.

Informacioni është i lirë dhe efektiv. Qeveria mund të subvencionoj ofrimin e informacioneve bazike që do të ndihmonin në rritjen e produktivitetit dhe mbijetesën e bizneseve.

Koordinimi i programeve të zhvillimit ekonomik duhet të përfshijë grupet që përfitojnë dhe grupet që mund të ofrojnë shërbime të veçanta. Zhvillimi ekonomik duhet të koordinohet në bazë të tregut lokal të fuqisë punëtore sepse është pikërisht aty ku shtohen përfitimet dhe ku ofrohen kontributet e bizneseve lokale. Bizneset private, institucionet arsimore dhe organizatat e komunitetit janë ndër grupet që duhet të përfshihen në zhvillimin ekonomik lokal, për shkak të mbështetjes së veçantë që ato mund tu japin përpjekjeve për zhvillim ekonomik lokal.

Përfundim

Meqë kjo është një përmbledhje e shkurtër e politikave, ne nuk kemi mundësi ta bëjmë këtë pjesë më gjithëpërfshirëse dhe të përfshijmë më shumë zgjedhje të politikave, edhe pse nga kjo do të përfitonin komunat, prandaj mendojmë se është i garantuar hulumtimi i ardhshëm në këtë fushë.

Sidoqoftë, me zgjedhjet aktuale të politikave ne kemi mundësi të kuptojmë më mirë kompetencat aktuale të komunave dhe politikat që kanë zgjedhur për të rritur zhvillimin ekonomik. Pothuaj të gjitha këto vegla janë në kuadër të kompetencave ligjore të komunave në Kosovë siç përcaktohet me ligjin mbi qeverisjen lokale. Në pjesën e analizës më poshtë, ne do të reflektojmë mbi këtë mundësi derisa marrim parasysh kompetencat ligjore dhe treguesit ekonomikë.

Ku jemi ne?

Gjendja e tregut të punës

Në njërin prej dokumenteve të shumta strategjike të institucioneve qendrore, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e paraqet këtë pasqyrë të përgjithshme për ekonominë e Kosovës: *“Sfidat kryesore zhvillimore vazhdojnë të mbesin në Kosovë. Problemi më urgjent është papunësia e lartë zyrtare dhe varfëria që lidhet me të, dhe BPV-ja relativisht e ulët (€ 1,795 për kokë banori në vitin 2009). Në vitin 2010 shkalla zyrtare e papunësisë mbërriti deri në 47% në dhe është edhe më e lartë në viset rurale. Përafërsisht 30 000 të rinj hyjnë në tregun e punës çdo vit. Këto probleme zhvillimore njihen në shumë dokumente strategjike zhvillimore të Kosovës dhe ka një fokusim gjithnjë e më të madh në sektorin privat, si gjenerator për rritje ekonomike shtesë për të krijuar më shumë mundësi për punësim të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, politikat efektive për zhvillimin e sektorit privat do të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në lehtësimin e rritjes ekonomike, të udhëhequr nga eksportet dhe investimet.”* (Republika e Kosovës, 2013)

Sipas ASK-së, shkalla e përgjithshme e papunësisë në Kosovë në vitin 2016 ishte 28%, ndërsa tek të rinjtë ajo vlerësohej deri në 50%. Përqindja e të rinjve që nuk janë të punësuar, që nuk janë duke vijuar shkollimin ose ndonjë program aftësimi ishte 28%. Pra, prej këtyre 50% të të papunëve, 28% e tyre nuk janë duke bërë asgjë. Dhe sipas departamentit për punë dhe punësim në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në vitin 2015, brenda periudhës 12 mujore, ka pasur në dispozicion një konkurs për vend pune për rreth 10 të papunë të regjistruar në zyrat për punësim. Sipas statistikave, çdo muaj më shumë se 116 të papunë është dashur të konkurrojnë për një vend pune. (*Shih Shtojcën A në fund të përmbledhjes për më shumë të dhëna statistikore*)

| Informacionet e tregut të punës për periudhën qershor 2013 - qershor 2014 sipas rajoneve | | | |
|--|----------------------------------|-------------------------------|--------------------------------------|
| | Nr. i të papunëve të regjistruar | Numri i regjistrimeve të reja | Të çregjistruarit (që janë punësuar) |
| Ferizaj | 32 080 | 1 654 | 380 |
| Gjakova | 14 893 | 1 762 | 660 |
| Gjilan | 31, 013 | 1, 907 | 732 |
| Mitrovica | 55, 658 | 1, 836 | 555 |
| Peja | 19, 606 | 1, 662 | 613 |
| Prishtina | 69 523 | 4 125 | 1 153 |
| Prizren | 49 323 | 2 791 | 675 |
| Gjithsej | 272, 096 | 15, 737 | 4768 |

Tabela 1: Burimi: Raporti vjetor nga departamenti i punës dhe punësimit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale 2014

Mozaiku i Kosovës (2015), një hulumtim për tërë vendin nga UNDP Kosovë, tregon se në tërë Kosovën, mungesa e zhvillimit ekonomik dhe pasojat e tij dominojnë listën e problemeve që perceptohen me prioritet të lartë. Pothuaj tri të katërtat e kosovarëve besojnë se **papunësia, mungesa e zhvillimit ekonomik dhe varfëria/standardi i ulët jetësor** janë problemet më të mëdha me të cilat përballen komunitetet e tyre².

Gjendja e mjedisit për biznes

Derisa papunësia mbetet e lartë, ARBK ka raportuar një rritje të vazhdueshme të numrit të bizneseve të reja. Vetëm në vitin 2016 kanë qenë mbi 10,000 biznese të reja që janë regjistruar në mbarë vendin, ku rreth 1/4 e tyre janë regjistruar në Prishtinë.

2

http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/kosovo-mosaic-2015.html




Tabela 2: Burimi: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë

Bizneset e reja nënkuptojnë mundësi të reja për punësim, megjithatë shkalla e papunësisë nuk ka rënë aq shumë prej vitit 2013, veçanërisht tek të rinjtë. Bazuar në një anketë me bizneset e vogla dhe të mesme (NVM), pengesat kryesore të jashtme të identifikuara për zhvillimin e NVM-ve dhe krijimin e vendeve të punës ishin:

- Qasja në financa (kreditë, shkalla e interesit, afatet kohore);
- Gjendja e përgjithshme ekonomike;
- Energjia elektrike;
- Konkurrenca jo-lojale (ndërmjet ndërmarrjeve lokale);
- Rrethanat në tregtinë e jashtme, etj.

Në vitin 2015, Qeveria e Kosovës mori një vendim të rëndësishëm për adresimin e njërës prej problemeve kyçe lidhur me fillimin e bizneseve të reja, që është qasja në financa, e vlerësuar negativisht nga indeksi i të bërit biznes. Qeveria ka krijuar [Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë](#), i cili është një organ lokal i pavarur i garancisë kreditore që u lëshon portfolio të garancive kreditore institucioneve financiare duke mbuluar deri në 50% të rrezikut të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM).

Deri më tani, bizneseve [u janë ofruar 416 kredi](#) me garanci në shumën prej 8,263,720 milionë eurosh.

Nga perspektiva e politikave, kjo ishte një prej mënyrave për të dëshmuar se qeveria (qoftë ajo qendrore, rajonale apo lokale) duhet të luaj rol në stimulimin e rritjes ekonomike dhe në krijimin e vendeve të punës.

Kosova radhitet e 60-ta nga 190 vende në indeksin e të bërit biznes, që është pozitë mjaft e mirë dhe që nënkupton se ka një ambient përgjithësisht të favorshëm për të bërë biznes në Kosovë, edhe pse në disa tregues ajo është vlerësuar negativisht.




FIGURA 1: BURIMI: BANKA BOTËRORE, 2017.

Roli i komunave në arsimin dhe aftësimin profesional dhe në punësim

Siç do ta shohim në pjesën e analizës më poshtë, kur është fjala për rolin direkt të komunave në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës, përveç politikave dhe strategjive për tatimet, marketing, informim, zona ekonomike dhe politika të tjera, politika kryesore është arsimit i cili u ndihmon të rinjve, atyre që presin në radhë për punësim dhe atyre që janë punësuar, të marrin aftësi të reja dhe më të mira për të pasur sukses në ekonominë moderne.

OECD thekson se aftësitë luajnë një rol të rëndësishëm në pajisjen e individëve për sukses afatgjatë në tregun e punës. Për të mbështetur individët në marrjen e vendimeve për arsim dhe treg të punës, rruga e arsimit dhe aftësimin profesional mund të bëhet më tërheqëse përmes udhëzimit më të mirë për karrierë dhe rrugëve të artikuluar mirë për arsim. Një sistem i plotë i aftësive lokale kërkon veprime të integruara në punësim, aftësim dhe politika të zhvillimit ekonomik (OECD, 2013).

Megjithatë, një fokus më i madh duhet të vihet në rini, pasi të qenit joaktiv në moshën e re ka reperkusione serioze tek individët për pjesën tjetër të jetës dhe ka mundësi të çoi në një **“gjeneratë të humbur”**

Lidhur me këtë, shërbimet e punësimit dhe institucionet e aftësimin duhet të angazhohen fuqishëm me punëdhënësit që ata të sigurohen më mirë që aftësitë e ofruara të plotësojnë kërkesën lokale.

Por a është kështu në Kosovë? Cilët mekanizma ekzistojnë për ofrimin e aftësimin profesional?

Nga pjesa për kompetencat ligjore e dimë se ligji për vetëqeverisjen lokale u jep komunave kompetenca dhe përgjegjësi për të ofruar arsim dhe aftësim. Neni 17 i ligjit thekson se është përgjegjësi e komunave për të ofruar arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;

Për më tepër neni 15 i të njëjtit ligj thotë se *“komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit”* duke u dhënë komunave kompetenca të zgjeruara sa herë që një fushë nuk është

rregulluar nga institucionet qendrore, dhe që kjo mund të arrihet më mirë nëse vepohet në nivelin lokal.

Aftësimi profesional në Kosovë

Vlerësimi i tregut për Sistemin e Tregut të Aftësive të AAP-së -- përmbledhje nga vlerësimi Përmirësimi i Punësimit të të Rinjve në vitin 2016 shkruar nga (Strategy & Development Consulting)

Në vitin 2013, Kosova miratoi Ligjin e ri për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, duke themeluar Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për Arsimin e të Rriturve (AAPARR) dhe duke caktuar përgjegjësi të reja për Këshillin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe për të Rritur (KAAPRR).

Në vitin 2014, papunësia e të rinjve u rrit në 61.0% nga 55.9% sa ishte në vitin 2013. Papunësia është më e lartë tek gratë e reja (71.7%) se sa tek meshkujt e rinj (56.2%). Për më tepër, pothuaj një e treta (30.2% e personave të moshës 15-24 vjeçare në Kosovë nuk janë në duke u shkolluar, të punësuar ose duke u aftësuar (NAPA).

Arsimi profesional është një ndër nën-sektorët më të rëndësishëm që i pajis nxënësit me aftësitë, njohuritë dhe kompetencat e kërkuara në tregun e punës.

Përafërsisht gjysma e të gjithë nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë janë regjistruar në një prej profileve të AAP-së në dispozicion: 51% e nxënësve në AAP krahasuar me 49% të nxënësve në arsimin e përgjithshëm të mesëm të lartë.

Megjithatë, tërheqja për AAP në radhët e nxënësve është e ulët dhe regjistrimi në AAP konsiderohet nga shumë si opsion i dytë pas dështimit për tu regjistruar në shkollat e mesme të larta të përgjithshme.

Në Kosovë, ka përafërsisht rreth 60 shkolla të mesme të larta profesionale, shumica e shkollave të AAP-së gjenden në komunat e Prishtinës (8), Gjilanit (5), Gjakovës (5), Pejës (4), Mitrovicës (4), Prizrenit (4) dhe Ferizajt (4). Komunat e tjera i kanë një ose dy shkolla të AAP-së. Pjesë e sistemit formal të shkollave të AAP-së në Kosovë janë edhe 4 Qendrat e Kompetencës (QK) të cilat u ofrojnë AAP fillestare dhe të më pastajme të rinjve dhe të rriturve.

Dokumentet strategjike

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 është zotimi më i fundit i Qeverisë për përmirësimin e lidhjes në mes të aftësive të fituara në arsim dhe nevojave të tregut të punës.

Normat dhe trendët shoqërorë

Shkollat profesionale në Kosovë vuajnë nga imazhi i dobët dhe tërheqja e vogël e të rinjve. Si hartuesit e politikave ashtu edhe profesionistët theksojnë se regjistrimi në AAP është opsioni i dytë pas dështimit për tu regjistruar në shkollat e mesme të larta të përgjithshme (gjimnaze).

Sektori privat:

Pjesëmarrja e sektorit privat është kritike për të siguruar që ofrimi i AAP-së të jetë i bazuar në kërkesë. Në Kosovë ka një numër organizatash me anëtarësi për profesione të ndryshme ose për sektorët e biznesit. Shoqatat kryesore të bizneseve në Kosovë janë Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), që përfshijnë disa shoqata profesionale dhe afariste të sektorëve specifik.

Sektori privat në Kosovë dominohet nga *ndërmarrësit solo* dhe *mikro-ndërmarrjet*. Këto dy kategori përbëjnë deri 95% të të gjitha bizneseve private në Kosovë dhe paraqesin 45% të tërë punësimit formal. Përkundër rëndësisë së tyre si krijues të vendeve të punës, NMVM-të në Kosovë vazhdojnë të përballen me barriera në mjedisin e biznesit. Në Anketën e Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Ndërmarrjeve (AMBPN), tri pengesat kryesore në mjedisin e biznesit të identifikuar nga firmat kosovare ishin: ***praktikat e konkurrentëve në sektorin joformal; problemet e energjisë; dhe korrupsioni.***

Struktura aktuale e sektorit privat, bashkë me modelin specifik të zhvillimit ekonomik të Kosovës, nuk është në gjendje të krijojë mjaft vende pune për të absorbuar personat e rinj që hyjnë në tregun e punës. **Përveç kësaj, shumë të rinj kosovarë nuk i kanë aftësitë e nevojshme për vendet e punës që janë në dispozicion (siç tregohet në tabelën 1).** Strategjia Sektoriale e Kosovës vlerëson se çdo vit krijohen rreth 15,000 vende pune, ndërsa 20,000 të rinj hyjnë në tregun e punës.

Punëdhënësit nuk janë të kënaqur me cilësinë e të diplomuarve dhe nuk janë të gatshëm t'i punësojnë ata. Të diplomuarit ankohen se aftësimi në shkolla nuk është adekuat dhe se kanë vështirësi në gjetjen e një vendi të kënaqshëm të punës në fushën e specializimit të tyre.

Shumë raporte që analizojnë sistemet e AAP-së në tërë BE-në kanë ardhur në përfundim se 'jorelevanca e kurrikulumit mund të jetë një prej pengesave më të mëdha në harmonizimin e arsimit dhe aftësimin të ofruar me nevojat e nxënësve dhe nevojat e tregut të punës'. Përfshirja e sektorit privat në zhvillimin e kurrikulës është kritike për të siguruar ndërlidhjen dhe cilësinë e arsimit dhe aftësimin profesional.

Tregu i punës

Kur analizohet tregu i punës, kërkesa merr parasysh punësimin dhe vendet e lira, përderisa ana e ofertës e kuantifikon papunësinë dhe regjistrimin në arsim.

Kërkesa

Shkalla e punësimin në Kosovë qëndron në 26.9%, shumë nën mesataren e BE-së që është 64.9%. Punësimi është dukshëm më i lartë tek meshkujt (41.3%) se sa femrat (12.5%). Të rinjtë e moshës 15 deri 24 vjeçare e kanë shkallën më të ulët të punësimin prej 9%. Individët me arsim të mesëm të lartë profesional përbënin 47.5% në fuqinë punëtore të sektorit privat. Në kushtet aktuale ekonomike, vlerësohet se çdo vit hapen rreth 15,000 vende pune. Numri i konkurseve për punësim të shpallura përmes Shërbimeve Publike të Punësimin (SHPP) në vitin 2014 ishte 6,566 vende, një rënie prej 5.9% krahasuar me vitin paraprak. Shumica e vendeve të lira të punës së shpallura përmes SHPP-së në vitin 2014 ishin në sektorin e shërbimeve (63%), pasuar nga sektori i prodhimit (22%) dhe sektori i bujqësisë (15%). Lidhur me nivelin e aftësive, shumica e vendeve të lira të punës kërkonin arsimin e mesëm (49%).

Oferta

Aktualisht pothuaj dy të tretat e tërë popullsisë është e moshës së punës (15 deri 64 vjeçare). Shkalla e papunësisë mbetet e lartë në vitin 2014, e vlerësuar në 35.3%, madje edhe nëse e krahasojmë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Papunësia e të rinjve është në shkallën 61.0% dhe është më e lartë tek gratë e reja (71.7%) se sa tek meshkujt e rinj (56.2%). Në vitin 2014, 83,000 nxënës ishin regjistruar në arsimin e mesëm të lartë dhe gjysma e tyre në shkollat profesionale (56.2%). Femrat përbënin 38% të nxënësve të AAP-së.

Funksionet dhe rregullat kyçe të tregut

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është organi përgjegjës për hartimin e politikave të punës dhe për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit në këtë fushë. Ligji Nr. 03/L-212 mbi Punën është korniza kryesore për rregullimin e fushës së të drejtave të punonjësve. Shërbimi Publik i Punësimit (SHPP) përbëhet nga 7 Qendra Rajonale dhe 23 Zyre Komunale dhe u ofron disa funksione punëkërkesve, siç është bashkërendimi i shërbimeve për vendet e punës dhe këshillimit.

Dinamika dhe performanca e tregut

Meqë Kosova ka një prej popullsive më të reja në Evropë, pritet që gjatë dekadës së ardhshme popullsia e moshës së punës do të shtohet me shpejtësi. Strategjia Sektoriale e Kosovës vlerëson se në pesë vitet e ardhshme, përafërsisht 110,000 të rinj do të hyjnë në tregun e punës, ndërsa, përafërsisht 60,000 njerëz do të arrijnë moshën e pensionimit, gjatë periudhës së njëjtë kohore.

Kosova përballlet me mungesë të punëtorëve me aftësi dhe njohuri adekuate për të plotësuar kërkesën e tregut të punës. Një prej arsyeve është mungesa e të dhënave të besueshme dhe me kohë mbi fuqinë punëtore që e bën të vështirë për ofruesit e AAP-së që të planifikojnë dhe ofrojnë programet përkatëse të arsimit dhe aftësisimit.

Drejtoritë Komunale të Arsimit

Kapacitetet

Kostot operative për funksionimin e DKA-së zbriten nga buxheti i përgjithshëm komunal. Çdo DKA udhëhiqet nga Drejtori i cili emërohet politikisht çdo katër vite pas zgjedhjeve komunale. Madhësia dhe përbërja e DKA-së ndryshon dukshëm nga një komunë në tjetrën. Për shembull, 5 komunitat më të mëdha (Prishtina, Prizreni, Ferizaj, Peja dhe gjakova) kanë nga 12 deri në 27 punonjës.

Në vitin 2014 raporti i NARMED tregon se personeli i DKA-së janë kryesisht të ngarkuar me funksione të mbështetjes së gjerë duke lënë pak hapësirë për ta që të përmbushin përgjegjësitë e tjera që janë brenda kornizës së Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë. Disa komuna kanë zhvilluar *Plane për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve*, dhe disa, si Prishtina dhe Gjilani, kanë *Plane për Zhvillimin e Arsimit*.

Stimulimet

Aftësitë dhe njohuritë janë forca shtytëse e rritjes ekonomike dhe zhvillimit social për secilën komunë. Duke mundësuar lidhjen ndërmjet shkollave të AAP-së dhe sektorit privat, ato sigurojnë disponueshmërinë dhe stabilitetin e fuqisë punëtore në nivel komunal. Niveli i arsimit dhe aftësimin të fuqisë punëtore përcakton potencialin e tyre për të kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe social. (Strategy & Development Consulting, 2016)

ANALIZË

Roli i komunave në zhvillimin ekonomik

Duke marrë parasysh kompetencat aktuale ligjore të komunave dhe zgjedhjet e politikave të paraqitura më lartë, është shumë e qartë se komunat duhet të luajnë një rol të madh kur është fjala për zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Zgjedhjet e politikave

Në çdo demokraci zgjedhjet janë ngjarja kryesore, jo vetëm pse kemi mundësi të ndryshojmë kryetarin e komunës dhe partinë që e udhëheq pushtetin lokal, por sepse mund të zgjedhim politikat që duam të ndjekim në vitet e ardhshme përmes përfaqësuesve tonë të zgjedhur me votë.

Natyrisht, demokracia kërkon qytetar aktiv, qytetar që i di zgjedhjet e politikave dhe që nuk mund të manipulohet lehtë, por në mungesë të një elektorati të informuar mirë, është roli i shoqërisë civile për tu angazhuar në mënyrë aktive si me qytetarët/elektoratin ashtu edhe me ata që garojnë në zgjedhje për të tejkaluar çështjet komplekse dhe për ta bërë më të lehtë të kuptuarit nga të dy palët.

Komunat në Kosovë kanë kompetenca ligjore e për më tepër e kanë obligim që të zhvillojnë ekonominë, të krijojnë vende pune dhe të ofrojnë arsim cilësor.

Më lartë kemi paraqitur disa zgjedhje të politikave të cilat bien nën kompetencat e komunave.

Neni 17 i ligjit për vetëqeverisje lokale u jep komunave kompetencë mbi zhvillimin ekonomik, i cili mund të plotësohet nga neni 15 mbi parimin e subsidiaritetit.

Kompetenca të tilla u mundësojnë komunave të zhvillojnë strategji dhe të ndjekin politika që mund të kenë ndikim në zhvillimin ekonomik. Në një dokument të qeverisë të titulluar "[Plani i Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014](#)," disa kompetenca reale bien në kuadër të komunave e të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, siç janë; përmirësimi i sistemit të tatimit në pronë; lehtësimi i fillimit të biznesit të ri; përmirësimi i sistemit arsimor dhe parandalimi i braktisjes së shkollës.

Tekstet sugjerojnë se komunat mund të përdorin kompetencat e tyre për të krijuar strategji që do të tërhiqnin bizneset për të investuar në komunat e tyre. Më lartë kemi paraqitur ato vegla dhe zgjedhje të politikave, por

këtu po i sjellim prapë duke i vendosur në kontekst të kompetencave ligjore.

Ofrimi i të dhënave ekonomike lokale dhe marketingu

Sipas kompetencave aktuale ligjore, komunat mund dhe duhet tu ofrojnë informata bizneseve mbi sistemin tatimor, lejet dhe rregulloret dhe informata të tjera që mund të kursejnë kohën e bizneseve fillestare por edhe mund të ofrojnë përparësi krahasuese me komunat e tjera. Ligji për vetëqeverisjen lokale u jep atyre kompetenca të mjaftueshme për të ofruar ato informacione.

a) Krijimi dhe mbajtja e zonave industriale

Ligji Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike rregullon krijimin e zonave ekonomike në Kosovë. Ndonëse procesi i shpalljes së zonave industriale është në masë të madhe i centralizuar, në parim komunat kanë kompetencë për të iniciuar krijimin e zonave ekonomike. Paragrafi 2 i nenit 5 thekson se “zonat ekonomike mund themelohen me vendim edhe nga komunat brenda territorit dhe në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.” Tekstet sugjerojnë se një planifikim dhe zonim më efektiv mund të ndihmojë në uljen e kostos së të bërit biznes për prodhuesit.

b) Stimulimet tatimore

Ligji Nr. 03/L-49 u jep komunave kompetencë për të krijuar të hyra përmes aplikimit dhe mbledhjes së tatimeve. Komunat mund të përdorin këtë kompetencë ose për të rritur ose ulur tatimet. Ato mund të bëjnë uljen e tatimit në pronë, lirime nga tatimi në shitje, lirime nga tatimi në të ardhura të korporatave dhe kredi të taksës së vendeve të punës të lidhur me numrin e punëtorëve të punësuar. Politikat efektive shpesh fokusohen në bizneset që janë në një fazë ku zhvillimi i tyre mund të preket nga intervenimet e politikave - siç janë bizneset fillestare dhe firmat që përballen me sfida konkurruese. Kur një kompani e ngushton zgjedhjen e saj të lokacionit në një rajon të caktuar, barra tatimore dhe karakteristikat fizike të lokacioneve potenciale mund të kenë më shumë ndikim mbi vendimin e saj (Cray, et al.).

Trajnimi dhe zhvillimi ekonomik shkojnë së bashku.

Për rritjen efektive të veprimtarisë afariste dhe për gjenerimin e përfitimeve nga punësimi, programet e zhvillimit ekonomik lokal duhet të përfshijnë programe të përshtatura të trajnimit që në mënyrë efektive tu shërbejnë nevojave të dy llojeve të klientëve, komunitetit të biznesit dhe të papunëve.

Siç e theksuam më lartë, në Kosovë ka përafërsisht rreth 60 shkolla të mesme të larta profesionale, shumica e shkollave të AAP-së gjenden në komunitet e Prishtinës (8), Gjilanit (5), Gjakovës (5), Pejës (4), Mitrovicës (4), Prizrenit (4) dhe Ferizajt (4). Komunitet e tjera i kanë një ose dy shkolla të AAP-së. Pjesë e sistemit formal të shkollave të AAP-së në Kosovë janë edhe 4 Qendrat e Kompetencës (QK) të cilat u ofrojnë AAP fillestar dhe të më pastajmë të rinjve dhe të rriturve.

Sidoqoftë, studimi i EYE tregon se punëdhënësit nuk janë të kënaqur me cilësinë e të diplomuarve dhe nuk janë të gatshëm t'i punësojnë ata. Të diplomuarit ankohen se aftësimi në shkolla nuk është adekuat dhe se kanë vështirësi në gjetjen e një vendi të kënaqshëm të punës në fushën ku kanë specializuar. Raporti thekson se shumë raporte që analizojnë sistemet e AAP-së në tërë BE-në kanë ardhur në përfundim se 'jorelevanca e kurrikulumit mund të jetë një prej pengesave më të mëdha në harmonizimin e arsimit dhe aftësimin të ofruar me nevojat e nxënësve dhe nevojat e tregut të punës'. Përfshirja e sektorit privat në zhvillimin e kurrikulës është kritike për të siguruar relevancën dhe cilësinë e arsimit dhe aftësimin profesional.

Kohëve të fundit, King College London (KCL) në Mbretërinë e Bashkuar ka refuzuar kurset për MBA pas bisedave me bizneset, "[sepse bizneset nuk po kërkojnë më MBA por talente, studentë që janë strategjikë në të menduar por që janë edhe të lakueshëm](#)".

| | Personat e papunë të regjistruar | Personat që kanë vijuar AAP-në | Konkurset e shpallura për vende pune | Të punësuar |
|------------------|----------------------------------|--------------------------------|--------------------------------------|---------------|
| | 2016 | 2016 | 2016 | 2016 |
| Ferizaj | 9, 628 | 931 | 3, 213 | 243 |
| Gjakova | 13, 146 | 439 | 1, 572 | 806 |
| Gjilan | 10, 445 | 417 | 1, 262 | 524 |
| Mitrovica | 15, 535 | 1, 013 | 1, 905 | 528 |
| Peja | 11, 880 | 1, 255 | 1, 633 | 569 |
| Prishtina | 24, 727 | 1, 205 | 1, 904 | 836 |
| Prizren | 16, 412 | 1, 476 | 2, 648 | 516 |
| Total | 101, 773 | 6, 736 | 14, 137 | 4, 022 |

Tabela : 1. Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

Komunitet dhe ministria e arsimit nuk duhet të punojnë vetëm për një cilësi më të mirë të arsimit aktual, bazuar në argumentet e paraqitura këtu, ato duhet të rishikojnë kurrikulat e ofruar në shkolla, veçanërisht në sistemin e AAP-së në mënyrë që arsimit të plotësojë nevojat e tregut. Tabela 1 tregon se ka një mospërputhje të madhe mes asaj çka duan bizneset dhe asaj çka mësohet në shkolla. Prej 14,137 vendeve të shpallura të punës

në vitin 2016, vetëm 4,022 persona që kishin vijuar AAP-në gjetën vend pune. Kjo duhet të jetë mjaft alarmuese për secilën komunë për të marrë masa të duhura që do të rezultojnë në pajisjen e njerëzve me aftësitë e kërkuara që i nevojiten tregut.

Duke ofruar arsim që i plotëson kërkesat e tregut, komunat luajnë një rol të rëndësishëm në punësim.

Përfundim

Shumë raporte theksojnë se Kosova vuan nga shkalla e lartë e papunësisë, mungesa e arsimit cilësor, mungesa e zhvillimit dhe mundësive. Përderisa qeveria qendrore duhet të luaj rol vendimtar përmes politikave qendrore, strategjive dhe stimulimeve, komunat nuk mbesin pa një rol.

Përmes ligjit për vetëqeverisjen lokale, komunat kanë kompetencë ligjore dhe obligim të punojnë dhe angazhohen në zhvillim ekonomik dhe punësim.

Kjo përmbledhje e politikave ishte në gjendje të nënvizojë kompetencat kryesore ligjore të komunave dhe të analizojë zgjedhjet e politikave që rrjedhin nga ato kompetenca.

Çdo komunë/qytet mund të ndjek një varg politikash dhe strategjish që mund të paraqesin përparësi krahasuese për lokacionin dhe veprimtarinë e biznesit. Resurset lokale natyrore, sistemi tatimor, veprimtaria afariste, zonat ekonomike dhe punëtorët e kualifikuar bien në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të komunave.

Ka ardhur koha që qytetarët të kërkojnë më shumë nga përfaqësuesit e tyre të tanishëm dhe të ardhshëm, që ata të mos ofrojnë vetëm shërbimet bazike por të zhvillojnë ekonominë lokale dhe të krijojnë vende pune.

Të vetëdijshëm për informacionin, fushëveprimin dhe mbulueshmërinë e kufizuar të saj, prapëseprapë besojmë se kjo përmbledhje e politikave është një kontribut i vogël për nisjen e një debati të madh për zhvillimin ekonomik dhe punësimin.

Bibliografia

- Bartik, T. J. (2003). *Local Economic Development Policies*. Upjohn Institute Working Paper No. 03-91. Kalamazoo, MI: W.E.: Upjohn Institute for Employment Research.
- Cray, A., Nguyen, T., Pranka, C., Schildt, C., Sheu, J., & Whitcomb, E. R. (a.d.). *Job Creation: A Review of Policies and Strategies*. Institute for Research on Labor and Employment . Berkeley University of California .
- International Labour Organization. (2016, June 08). *International Labour Organization*. Gjetur 08 22, 2017, nga International Labour Organization: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---protrav/---travail/documents/genericdocument/wcms_508566.pdf
- OECD. (2013). *Local Job Creation: How Employment and Training Agencies Can Help. Ireland*. OECD, LEED.
- Republic of Kosovo. (2013). *PRIVATE SECTOR DEVELOPMENT STRATEGY 2013 - 2017*. Ministry of Trade and Industry. Prishtine: Ministry of Trade and Industry.
- Strategy & Development Consulting. (2016). *Vlerësimi i Sistemit të Tregut të Shkathtësive në AAP*. Prishtine: EYE.